



Dalim së bashku nga pandemia

Jepni kontributin tuaj personal: Sa më shumë njerëz të vaksinohen në Zvicër, aq më shpejt do t'i jepet fund kësaj pandemie. Vaksina ju mbron vetë juve nga sëmundja me Covid-19 në gjendje të rëndë. Dhe ajo zvogëlon gjithashtu rrezikun që të përhapni virusin dhe që t'ia transmetoni atë personave të tjerë.

foph-coronavirus.ch/vaccination

Linja telefonike e vaksinimit ndaj COVID-19: **0800 88 66 44**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Përse nevojitet vaksinimi?

Koronavirusi është shumë infektues. Një pjesë e personave të prekur, e kalojnë atë në gjendje të rëndë. Mbi 90% e pacientëve të repartet e kujdesit intensiv janë persona të pavaksinuar. Infektimet mund të rezultojnë edhe në pasojat afatgjata: Në simptomat afatgjata të Covid përfshihen vështirësia në frymëmarrje, ndjesia e lodhjes dhe dobësimi i kapacitetit fizik. Këto mund të prekin edhe të rinjtë dhe të rriturit.

Çfarë sjell vaksinimi?

Të gjitha vaksinat e miratuara për përdorim në Zvicër kanë një efikasitet shumë të lartë dhe ju mbrojnë nga një sëmundje me Covid-19 në gjendje të rëndë. Vaksina zvogëlon gjithashtu rrezikun e përhapjes së mëtejshme të virusit – kështu ju mund të mbron veten dhe personat veçanërisht të rrezikuar në familjen tuaj, në shtëpinë tuaj, në rrethin shoqëror dhe në ambientin e punës. Sa më shumë persona të vaksinohen, aq më pak do të qarkullojë virusi në shoqëri dhe aq më pak njerëz do të sëmuren apo do të humbin jetën nga koronavirusi.

Përmbledhje e avantazheve të vaksinimit:

- Minimizon rrezikun e infektimit të vetë personit me koronavirus.
- Parandalon gjendjen e rëndë nga infektimi me Covid-19 dhe pasojat afatgjata që vijnë prej tij.
- Ul rrezikun e përhapjes së mëtejshme të virusit.
- Liron nga mbingarkesa sistemin shëndetësor.
- Kontribuon që të jetë e mundur një liri më e madhe në jetën e përditshme.

Si funksionon vaksina?

Vaksina e Covid-19 i jep mundësinë trupit të krijojë një mbrojtje imunitare të drejtuar në mënyrë të veçantë kundër virusit. Kur trupi ekspozohet ndaj virusit, ai mund ta luftojë virusin dhe të parandalojë sëmundjen nga virusi. Në këtë mënyrë vaksina fuqizon dhe trajnon sistemin tonë imunitar në mënyrë shumë specifike kundër koronavirusit.

Çfarë vaksinash ka në dispozicion?

Për momentin në Zvicër ka në dispozicion dy vaksina mRNA dhe një vaksinë me vektor. Mënyrën sesi funksionojnë këto e mësoni këtu:



Video e vaksinës mRNA
vimeo.com/492783396



Video e vaksinës me vektor
vimeo.com/509686017

A është e sigurt vaksina?

Çdo vaksinë për përdorim në Zvicër ka nevojë për një miratim. Që të marrë këtë miratim, ajo duhet të plotësojë kërkesat e rrepta lidhur me sigurinë, efikasitetin dhe cilësinë. Instituti Zviceran i Barnave Swissmedic ka kontrolluar dhe aprovuar me kujdes vaksinat kundër Covid-19. Ato janë të sigurta dhe efikase.

Kujt i rekomandohet vaksinimi?

- Të gjithë personave mbi 12 vjeç
- Grave shtatzëna (për mbrojtjen e nënës dhe foshnjës së palindur) dhe grave që ushqejnë fëmijët me gji
- Personat që e kanë kaluar sëmundjen (nevojitet vetëm një dozë, sepse infektimi vepron si një dozë vaksine)

Për të rinjtë e moshës 12 deri në 17 vjeç, për gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë fëmijë me gji, si dhe për personat me sistem imunitar të dobët rekomandohen vetëm vaksinat mRNA.

Ku mund të vaksinohem?

Vaksina mund të bëhet në qendrat e vaksinimit, në spitale ose farmaci, te mjeku i familjes dhe në ambientet e shërbimeve të lëvizshme për vaksinimin. Informohuni për datat e vaksinimit në kantonin ku banoni në:
foph-coronavirus.ch/cantons

Ku mund të gjej më shumë informacion?

Në faqen e internetit **foph-coronavirus.ch/vaccination** gjeni të gjitha informacionet e rëndësishme, adresat dhe materialet për shkarkim.

Këtu përfshihen:

- Video informuese dhe sqaruese lidhur me vaksinimin
- Fakte rreth vaksinimit
- Informacione mbi certifikatën për Covid
- Materiale informuese për shkarkim
- Informacione për udhëtimet jashtë shtetit

Linja telefonike e vaksinimit ndaj COVID-19: **0800 88 66 44**

Informacionet për vaksinimin në gjuhë të tjera:
foph-coronavirus.ch/languages

